



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 3 shkurt 2026 Gjykatësi i çështjes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit.

Gjykatësi konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku real se z. Thaçi mund të pengojë procesin e Dhomave të Specializuara dhe të kryejë vepra penale të tjera. Gjykatësi pranoi se rreziku i pengimit të drejtësisë është më i ulët krahasuar me rishikimet e mëparshme të paraburgimit, duke pasur parasysh përfundimin e paraqitjes së provave në gjykimin e z. Thaçi për krime lufte dhe faktin se Prokuroria kërkon të mbështetet pothuajse ekskluzivisht në prova shkresore në gjykimin e z. Thaçi në lidhje me akuzat për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve.

Sidoqoftë, Gjykatësi vlerësoi se vazhdon të jetë i pranishëm një rrezik real, mbështetur në dyshimin e bazuar për përpjekje të gjera të z. Thaçi për të penguar procesin në gjykimin e tij për krime lufte dhe në pretendimin se pjesë e këtyre përpjekjeve ishte kërkimi i bashkëpunimit prej, dhe dhënia e udhëzimeve, individëve që janë të lirë në Kosovë. Gjykatësi mori parasysh gjithashtu mundësinë aktuale që individë të cilët mund të thirren si dëshmitarë të Mbrojtjes në gjykimin e ardhshëm të z. Thaçi, identitetet e të cilëve nuk janë të ditura, mund të jenë objekt i ndikimit.

Gjykatësi i çështjes konstatoi gjithashtu se asnjë kusht jashtë paraburgimit nuk mund të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe vuri në dukje se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara zvogëlojnë ndjeshëm mundësinë e ndikimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të z. Thaçi ndaj dëshmitarëve. Së fundi, Gjykatësi gjykoi se periudha e paraburgimit vazhdon të jetë e arsyeshme dhe proporcionale dhe thekson se paraburgimi do të rishikohet rregullisht çdo dy muaj.

Në të njëjtën çështje, më 29 janar, Gjykatësi i çështjes përcaktoi protokollin dhe afatet për kundërshtimet që palët mund të dëshirojnë të paraqesin ndaj saktësisë së transkripteve të vizitave që i janë bërë z. Thaçi në paraburgim. Kjo lidhet me transkripte që janë pjesë e provave të propozuara nga prokuroria në këtë çështje, ku pretendohet se z. Thaçi dha udhëzime për ndikim tek dëshmitarët. Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje u vetëdeklaruan të pafajshëm.

Në një vendim tjetër më 29 janar, Gjykatësi i çështjes bëri konstatim gjyqësor të një fakti të shqyrtuar në procese të tjera në lidhje me atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Rregullorja përcakton se, në interes të gjyimit të drejtë dhe të shpejtë, gjykatësit në një çështje mund të mbështeten në fakte të konstatuara në çështje të tjera në Dhomat e Specializuara dhe në gjykata të tjera të Kosovës.

1





Gjykatësi u mbështet në faktin se “ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, në veçanti në lidhje me hetimet/ndjekjen penale të krimeve që u atribuohen ish anëtarëve të UÇK-së.”

Në vendimin e tij, Gjykatësi i çështjes citoi konstatime të pranuar në tri çështje të tjera, përfshirë një çështje ku dhanë dëshmi një ekspert i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe një punonjës i mbrojtjes së dëshmitarëve, dhe dy aktgjykime në të cilat ky fakt u vërtetua bazuar në dëshmitë e disa dëshmitarëve të cilët përshkruan përvojat e tyre personale të frikësimit të dëshmitarëve.

Në çështjen Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës, më 29 janar, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin e parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës mbi një apel kundër një urdhri për zhdëmtim. Versioni i redaktuar publik mund të gjendet në faqen e internetit.

Paneli i Apelit konfirmoi urdhrin për zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjykues kundër z. Shala pas shpalljes së tij fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme. Në tërësi, tetë viktimat morën pjesë në proces dhe kërkuan zhdëmtim. Më 29 nëntor 2024, Trupi Gjykues urdhëroi z. Shala të paguajë shumën prej 208,000 euro si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që pësuan viktimat pjesëmarrëse.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kujtojmë se deklaratat përmbyllëse janë planifikuar të paraqiten javën e ardhshme, nga data 9 deri më 13 shkurt, dhe më 16 dhe 18 shkurt. Seancat janë planifikuar të fillojnë në orën 09:00 dhe të përfundojnë në orën 16:30 dhe mund të përcillen përmes internetit në tri gjuhët e gjykatës, shqip, anglisht, dhe serbisht, përmes [transmetimit në faqen e internetit të KSC-së](#), me 45 minuta vonesë. Rendi i ditës për deklaratat përmbyllëse është bazuar në vlerësimet aktuale dhe mund të ndryshojë, për shembull, nëse një palë ka nevojë për më pak kohë seç mendohej.

Për shkak të interesit të madh për të marrë pjesë në seancat e këtyre ditëve, siç është bërë e ditur më parë, pararegjistrimi ishte kusht për pjesëmarrje në seanca nga galeria për publikun në ndërtesën e gjykatës në Hagë. Afati i pararegjistrimit ka përfunduar dhe pararegjistrimi nuk është më i mundur. Konfirmimet në lidhje me pararegjistrimet do të dërgohen deri nesër, më 6 shkurt. Nuk kërkohet pararegjistrim për të përcjellë seancat përmes transmetimit në internet.

Gjatë deklaratave përmbyllëse, Prokuroria dhe Mbrojtja do të paraqesin përmbledhje të argumenteve të tyre. Mbrojtja e Viktimave do të flasë për ndikimin që krimet e pretenduara kanë pasur ndaj viktimave.

Pas kësaj, Trupi Gjykues do të fillojë kuvendimet konfidenciale.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 04/2026
Hagë, 05/02/2026

Gjykatësit do të vlerësojnë me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë dhe peshën e dëshmive të dëshmitarëve dhe të secilës provë.

Të akuzuarit presumohen të pafajshëm derisa prokuroria nuk vërteton fajësinë e tyre jashtë dyshimit të arsyeshëm.

